



**BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 2912 / 2 Prot.

Rrëshen më, 08 . 08 . 2025

V E N D I M

Nr. 64 datë 01. 08. 2025

P Ë R

**NDRYSHIMIN E EMËRTIMIT TË RRUGËS NGA “KODER RRESHEN 03190021” NË
RRUGA “ATË LINO NICOLAI”, FSHATI KODËR RRËSHEN, NJËSIA
ADMINISTRATIVE RRËSHEN, 4602, BASHKIA MIRDITË.**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.1 shkronja “b”, pika 1/1.7. shkronja “b” e nenit 54, shkronja “ll” e nenit 55 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, pikave 1, 3 dhe 4 të nenit 1/1, nenit 3 të ligjit nr 9270 datë 29.07.2004 “Për sistemin e adresave” (të ndryshuar), shkronja “dh” të pikës nr. 2 të nenit nr. 11 të ligjit nr. Nr. 72/2012 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe bazuar në propozimin të protokolluar me shkresën nr. 2926 prot, datë 22.07.2025 të Dioqezës Mirditë, bashkëlidhur projekt – vendimit të paraqitur nga Kryetari i Bashkisë, *shqyrtimin e miratimit në mbledhjen e datës 28.07.2025, të Komisionit Kulturës, Trashëgëmisë Kulturore, Dhënies Titujve, Emërtimeve për t’a kaluar në seancën e Këshillit Bashkiak, pas diskutimeve;*

V E N D O S I:

1. Të miratojë ndryshimin e emërtimit të rrugës nga rruga “KODER RRESHEN 03190021”, në rruga “ATË LINO NICOLAI”, fshati Kodër Rrëshen, njësia administrative Rrëshen, kodi postal 4602, Bashkia Mirditë.
 - Bashkëlidhur planvendosja e rrugës në Shkallë, Sh 1: 2, 500.
 - Rruga fillon nga shkolla e fshatit, dhe përfundon te Kisha e Kodër Rrëshen.
 - Rruga përfshirë të gjitha degëzimet në ndërtesat ekzistuese shtrihet në një gjatësi prej 460 mL, me gjerësi kaluese 3.5 mL.
2. Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit dhe Strehimit (D.P.Zh.T.S), të zbatojë procedurën për ndryshimin e emërtimit në Gjeoportalin ASIG dhe në Regjistrin Kombëtar të Adresave (RKA) sistemi Adresari.

3. Çdo vendim i mëparshëm që bie ndesh me parashikimet e pikës 1, të këtij vendimi shfuqizohet.
4. Ngarkohet, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi Kryetari i Bashkisë Mirditë, (Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit dhe Strehimit).

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar!


SEKRETAR

Gaspër TOPOLLAJ



KRYETAR

Aleksandër PICA KU





BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2912/1 Prot.

Rrëshen më, 22 . 07 . 2025

P / V E N D I M

Nr. 65 datë 22 / 07 / 2025

PËR

**NDRYSHIMIN E EMËRTIMIT TË RRUGËS NGA “KODER RRESHEN 03190021” NË
RRUGA “ATË LINO NICOLAI”, FSHATI KODËR RRËSHEN, NJËSIA
ADMINISTRATIVE RRËSHEN, 4602, BASHKIA MIRDITË.**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.1 shkronja “b”, pika 1/1.7. shkronja “b” e nenit 54, shkronja “ll” e nenit 55 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, pikave 1, 3 dhe 4 të nenit 1/1, nenit 3 të ligjit nr 9270 datë 29.07.2004 “Për sistemin e adresave” (të ndryshuar), shkronja “dh” të pikës nr. 2 të nenit nr. 11 të ligjit nr. Nr. 72/2012 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe bazuar në propozimin të protokolluar me shkresën nr. 2926 prot, datë 22.07.2025 të Dioqezës Mirditë, bashkëlidhur projekt – vendimit të paraqitur nga kryetari i bashkisë në këshillin bashkiak, pas diskutimeve të anëtarëve të këshillit bashkiak në seancë;

V E N D O S I:

1. Të miratojë ndryshimin e emërtimit të rrugës nga rruga “KODER RRESHEN 03190021”, në rruga “ATË LINO NICOLAI”, fshati Kodër Rrëshen, Njësia Administrative Rrëshen, kodi postal 4602, Bashkia Mirditë.
Bashkëlidhur planvendosja e rrugës në Shkallë, Sh 1: 2, 500.
Rruga fillon nga shkolla e fshatit, dhe përfundon te Kisha e Kodër Rrëshen.
Rruga përfshirë të gjitha degëzimet në ndërtesat ekzistuese shtrihet në një gjatësi prej 460 mL, me gjërësi kaluese 3.5 mL.
2. Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit dhe Strehimit (D.P.Zh.T.S), të zbatojë procedurën për ndryshimin e emërtimit në Gjeoportalin ASIG dhe në Regjistrin Kombëtar të Adresave (RKA) sistemi Adresari.
3. Çdo vendim i mëparshëm që bie ndesh me parashikimet e pikës 1 të këtij vendimi shfuqizohet.

4. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit dhe Strehimit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.

SEKRETARI

Gasper TOPOLLAJ

KRYETARI

Aleksandër PICA KU

Paraqiti Projektin:

Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit Territorit: Juljan TUSHAJ

Drejtoria Juridik/Prokurimeve:

Majlinda TOPOLLAJ

KRYETARI

Albert MËLYSHI





BASHKIA MIRDITË

Nr. 2912 Prot.


Rrëshen më, 22 . 07 . 2025

RELACION I P/VENDIMIT “NDRYSHIMIN E EMËRTIMIT TË RRUGËS NGA “KODER RRESHEN 03190021” NË RRUGA “PADER LINO NICOLAI”, FSHATI KODËR RRESHEN, NJËSIA ADMINISTRATIVE RRESHEN, 4602, BASHKIA MIRDITË.

Drejtuar: Anëtarëve të Këshillit bashkiak Mirditë!

Të nderuar këshilltarë!

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.1 shkronja “b”, pika 1/1.7. shkronja “b” e nenit 54, shkronja “ll” e nenit 55 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, pikave 1, 3 dhe 4 të nenit 1/1, nenit 3 të ligjit nr 9270 datë 29.07.2004 “Për sistemin e adresave” (të ndryshuar), shkronja “dh” të pikës nr. 2 të nenit nr. 11 të ligjit nr. Nr. 72/2012 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe bazuar në propozimin të protokolluar me shkresën e Dioqezës Mirditë me nr. 2926 prot, datë 22 / 07 /2025 të Dioqezës Mirditë, parashtrojmë para Jush relacionin për miratimin e P/Vendimit të sipërcituar. **Rruga fillon nga shkolla e fshatit, dhe përfundon te Kisha e Kodër Rrëshen. Rruga përfshirë të gjitha degëzimet në ndërtesat ekzistuese shtrihet në një gjatësi prej 460 mL, me gjerësi kaluese prej 3.5 mL.**



ADRESA: SHESHI “ABAT DOÇI”, RRESHEN

email: bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.al

Bashkëlidhur projekt – vendimit të paraqitur nga kryetari i bashkisë në këshillin bashkiak, gjeni:

1. *Planvendosjen e rrugës;*
2. *Kërkesën e Dioqezës Mirditë;*
3. *Promemorjen e hartuar nga DIOQEZA ;*

Me respekt:

Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit Territorit: Juljan TUSHA

Drejtoria Juridik/Prokurimeve:

Majlinda TOPOLLAJ

KRYETARI

Albert MELYSHI





Dioqeza e Rrëshenit
Dioecesis Rresceniensis

Prot. Nr. 82/2025

Nr. 2926 Prot
Dt. 22.07.25



Rrëshen, 22.07.2025

Shumë të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak,

Me anë të kësaj letre, po ju paraqes një kërkesë.


Duke pasur parasysh se këtë vit është 10-vjetori i vdekjes së **Atë Lino Nicolai-t c.m.**, do të ishte në nderin e qytetit dhe një shenjë mirënjohjeje ndaj të ndjerit Atë Lino, që një rrugë të Bashkisë sonë të Mirditës, t'i vendosej emri i tij. Konkretisht, ne propozojmë dhe kërkojmë që rruga e cila mund të mbajë emrin e Atë Lino Nicolai-t, të jetë ajo e Kodër-Rrëshenit, që nis nga Unaza e qytetit dhe përfundon te kisha e shna Prenes.

Atë Lino Nicolai ka ardhur në Shqipëri qysh në fillimet e demokracisë dhe ka shërbyer me përkushtim deri në fund të jetës së tij në Rrëshen dhe në fshatrat përreth. E dimë të gjithë lidhjen shpirtërore që Atë Lino ka pasur me njerëzit e këtij vendi, sa i ka dashur, por edhe se sa e kanë dashur e respektuar edhe ata gjithashtu. Në mënyrë të veçantë, Kodër-Rrësheni ka qenë një pikë e rëndësishme e angazhimit të tij, duke kontribuar në ndërtimin e kishës dhe duke ndihmuar shumë familje.

Me gjithë moshën e tij të shtyer në vitet e fundit, ai nuk u ndal asnjëherë në shërbimin e tij dhe në afërsinë ndaj njerëzve, ndaj të gjithë njerëzve. Jam i bindur se me këtë kërkesë shpreh edhe vullnetin e dëshirën e të gjithë banorëve të Kodër-Rrëshenit dhe të atyre që e kanë njohur nga afër Atë Lino-n e me siguri ka prej tyre edhe midis jush si anëtarë të Këshillit Bashkiak.

Duke shpresuar se kjo kërkesë do të aprovohet nga ana juaj në këtë 10-vjetor të kalimit të tij në amshim, ju përshëndes e ju uroj çdo të mirë në punën dhe në familjet tuaja,

Me nderime,


+ **Gjergj Meta**
Ipeshkëv i Rrëshenit



KËSHILLI BASHKIAK

MIRDITË